




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. 2-D/DPK Nr. Prot. 01-4553/13
 Dep. Prot. No. 01-4553/13
 Nr.faq. Data 31.12.2013
 Broj stranica Datum 31.12.2013
 Nr. pages 02 Date 31.12.2013

PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	13/12/2013
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Isa OSMANKAJ Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Prizrenit
CC:	z. Ramadan MUJA Kryetar i Komunës së Prizrenit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për Tenderin: "Ndërtimi me elemente betoni i rrugës në lagjen Xhoxhaj në Petrovë të Prizrenit", me nr. Prokurimi: 622-13-353-521 në Prizren"



Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin: Ndërtimi me elemente betoni i rrugës në lagjen Xhoxhaj në Petrovë të Prizrenit", me nr. Prokurimi: 622-13-353-521", Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin e procesit të prokurimit, për tenderin: "Ndërtimi me elemente betoni i rrugës në lagjen Xhoxhaj në Petrovë të Prizrenit", me nr. Prokurimi: 622-13-353-521, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit në pajtim me Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik. Gjatë monitorimit të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka konstatuar ndonjë shkelje të dispozitave të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Komuna e Prizrenit me datën 01.11.2013 përmes KRPP-së ka shpallur “Njoftim për Kontratë” për tenderin “Ndërtimi me elemente betoni i rrugës në lagjen Xhoxhaj në Petrovë të Prizrenit”, me nr. Prokurimi: 622-13-353-521”.

Divizioni i Parandalimit të Korrupsionit në Prokurim Publik në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë monitorimit të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka hasur në ndonjë shkelje që mund të shpie drejt shpërblimit me kontratë në bazë jo meritore.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt!